

Puna e Ditëve të Mëvonshme për të Vdekurit



Plaku Xhon A. Uidso (1872–1952), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim sa vijon lidhur me misionin tonë të parachuguruar për t'i ndihmuar bijtë dhe bijat e Perëndisë:

“Në gjendjen tonë të paraekzistencës, në ditën e këshillit të madh, në bëmë një marrëveshje të caktuar me të Plotfuqishmin. Zoti propozoi një plan, të hartuar prej Tij. Ne e pranuan atë. Duke qenë se plani synohet për të gjithë njerëzit, ne bëhemi palë për shpëtimin e çdo njeriu sipas atij plani. Ne ramë dakord, pikërisht atëherë dhe atje, që të jemi shpëtimtarë jo vetëm për vetveten, por . . . shpëtimtarë për të gjithë familjen njerëzore. Ne hymë në një ortakëri me Zotin. Funksonimi i planit u bë pra, jo thjesht puna e Atij dhe puna e Shpëtimtarit, por edhe puna jonë. Më të paktët prej nesh, më të përluriturit, janë në ortakëri me të Plotfuqishmin për arritjen e qëllimit të planit të përgjithshëm të shpëtimit (“The Worth of Souls”, *Utah Genealogical and Historical Magazine*, tetor 1934, f. 189)” (në *Doctrine and Covenants and Church History: Gospel Doctrine Teacher’s Manual* [1999], f. 173).



Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, i nxiti të rinjtë të bëjnë punën e tempullit për vetë paraardhësit e tyre:

Çfarëdo pune që bëni në tempull, është kohë e shpenzuar mirë, por marrja e ordinancave si mëkëmbës për një nga vetë paraardhësit tuaj do ta bëjë kohën në tempull më të shenjtë dhe bekime edhe më të mëdha do të merren. . . .

Ju të rinj, a dëshironi një mënyrë të sigurt për ta larguar ndikimin e kundërshtarit në jetën tuaj? Zhytuni

në kërkimin për paraardhësit tuaj, përgatitini emrat e tyre për ordinancat e shenjta mëkëmbëse të disponueshme në tempull dhe pastaj shkoni në tempull për të qëndruar si mëkëmbës për ata për të marrë ordinancat e pagëzimit dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë. Nuk mundem të mendoj për mbrojtje më të madhe nga ndikimi i kundërshtarit në jetën tuaj” (“Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve”, *Ensign ose Liahona*, nëntor 2012, f. 93–94).



Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, bëri ftesën dhe premtimin vijues:

“I ftoj të rinjtë e Kishës që të mësojnë e të përjetojnë Shpirtin e Elias. Ju inkurajoj që të studioni, të gjeni paraardhësit tuaj e të përgatitini për të kryer pagëzime mëkëmbëse në shtëpinë e Zotit për të vdekurit e farefisit *tuaj* (shih DeB 124:28–36). Dhe ju nxi[t] që të ndihmoni njerëz të tjerë për të gjetur historitë e tyre familjare.

Kur i përgjigjeni me besim kësaj ftese, zemra juaj do të kthehet drejt etërve. Premtimet që iu bënë Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, do të nguliten në zemrën tuaj. Bekimi juaj patriarkal, me shpalljen prej tij të linjës së prejardhjes, do t’ju lidhë te këta etër e do të jetë për ju më kuptimplotë. Dashuria dhe mirënjohja për paraardhësit tuaj do të shtohet. Dëshmia juaj për Shpëtimtarin dhe kthimi në besim tek Ai do të bëhen të thellë dhe të qëndrueshëm. Dhe unë ju premtoj se do të jeni të mbrojtur ndaj ndikimit në rritje të kundërshtarit. Ndërsa merrni pjesë dhe e doni këtë punë të shenjtë, ju do të mbrohëni në rini dhe gjatë gjithë jetës suaj” (“Zemrat e Fëmijëve do të Kthehen”, *Ensign ose Liahona*, nëntor 2011, f. 26–27).

